



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 27.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Frashër Krasniqi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi dhe Shkumbin Demaliaj.

Mungoi: Jelena Bontiq

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Egzon Murturi, KDI; Shqipe Pajaziti, Kosova Press; Fitore Sopjani, Infokusi; Erëblinë Ajazi, Kuvendi; Shaban Murturi dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EUO; Sanije Berisha, OSBE; Rreze Hoxha, GLPS; Granit Osa, praktikant; Besjana Bajrami, EO; Kaltrina Ajvazi, IKD; Blendon Arifi, Edison Sylja dhe Bekim Ibishi, praktikant UP.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.10.2018;
3. Shqyrtimi i propozimeve me kandidatët për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës ;

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u futur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligjin nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Projektligjin nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.10.2018

Albulena Haxhiu, kryetare, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9.10.2018, pa vërejtje. Më tej z. Haxhiu tha që të theksohet në procesverbal se me sa vota për, kundër dhe abstenim miratohen apo nuk miratohen secila pikë e rendit të ditës nga anëtarët e komisionit.

3. Shqyrtimi i propozimeve me kandidatët për anëtarë të Këshillit për Ndhmë Juridike Falas;

Kryetarja, paraqiti në shqyrtim propozimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit për Ndhmë Juridike Falas dhe tha se pasi kemi kërkuar dokumentacion shtesë, janë edhe disa çështje që duhet të diskutohen. Ligji për Ndhmë Juridike Falas, neni 11, ku flitet për kushtet që duhet ti plotësojnë anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës për anëtarë në Këshillin për Ndhmë Juridike Falas, të cilat janë të specifikuar. Haxhiu si kusht përmendi përvojën dhe njohuritë në sistemin e drejtësisë sepse shumë prej këtyre, që janë propozuar nga ministrinë, përkatëse nuk kanë përvojë në sistemin e drejtësisë, si p.sh. nga Ministria e Financave ose nga OJQ-të. Më tej znj. Haxhiu përmendi disa emra që nuk i kanë plotësuar kushtet ose nuk kanë sjellë dokumentet plotësuese dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen.

Sami Kurteshi, tha se ligji kërkon që të kenë përvojë në sistemin e drejtësisë dhe nëse shihet kaq ngushtë sistemi i drejtësisë, janë gjykatat, prokuroritë ose ndonjë institucion tjetër që merret ekskluzivisht me çështjet e drejtësisë, por nëse do ishim pak më zemërgjerë do duhej të ishte përvojë në çështje juridike. Më tej z. Kurteshi tha se përveç përfaqësuesit e Gjykatës Supreme, askush nuk i plotëson kushtet sipas ligjit, duke pohuar se është kundër për të përkrahur këto propozime, kur shumica e tyre nuk i kanë plotësuar kushtet.

Shkumbin Demaliaj, tha se meqenëse po flasim për një institucion që ndihmon një pjesë të popullsisë, që nuk kanë mundësi për mbrojtje nëpërmjet avokatëve, kërkoi që të rekomandohet për seancë plenare dhe të njëjtat vërejtje mund të bëhet edhe në seancë.

Sami Kurteshi, sqaroi se Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, është shumë i rëndësishëm dhe në përbërje të këtij Këshilli, duhet të jenë juristë të mirë, që përfaqësojnë njerëz në nevojë dhe që nuk kanë mundësi të marrin avokat sepse të gjithë këta merren me mbrojtjen e viktimave.

Hajdar Beqa, pasi përmendi kronologjinë, se kur kanë ardhur në Kuvend, propozoi që propozimet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, të procedohen për seancë, pasi që mandati i anëtarëve aktual iu skadon më 29.11.2018.

Korab Sejdiu, tha se interpretimi i sistemit të drejtësisë në kuptimin e ngushtë, duke përmendur vetëm kategoritë kushtetuese, është jashtëzakonisht i paarsyeshëm sepse sistemi i drejtësisë është më i gjerë sesa ato që janë përmendur në Kushtetutë. Sejdiu, tha se jam për disiplinim të institucioneve, në mënyrë që ata të mësohen ta dërgojnë dokumentacionet ashtu si duhet dhe propozoi që lënda ti kthehet institucionit për kompletim.

Arben Gashi, propozoi që ti dërgohet seancës, duke e cekur secilin institucion një për një se kush i plotëson kushtet sipas kritereve, ashtu siç i ka përcaktuar ligji. Po ashtu, tha që jo domosdoshmërisht, duhet të jenë të lëmit juridik që duhet të japim interpretim të ngushtë të ligjit. Më tej shtoi se të gjitha institucionet i plotësojnë kushtet formale-juridike, përveç kandidatëve të propozuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe OJQ-ve.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me 7 vota për, dhe 2 abstenime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I. Të emërohet njëri nga kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike

falas, nga **Ministria e Drejtësisë**:

1. Labinot Gashi;
2. Besim Zllashi dhe
3. Fisnik Krasniqi;

II. Të emërohet njëri nga kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike

falas, nga **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:**

1. Hidajete Vokshi;
2. Skender Asllani dhe
3. Zemrije Limaj;

III. Të emërohet njëri nga kandidatet e propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike

falas, nga **Ministria e Financave:**

1. Shyqyri Hyseni;
2. Orhan Devaja dhe
3. Lumnije Hetemi;

IV. Të emërohet njëri nga kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike

falas, nga **Oda e Avokatëve të Kosovës:**

1. Admir Salihu;
2. Muhamet Humolli dhe
3. Muharrem Hoti;

V. Të emërohet njëri nga kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike

falas, nga **Gjykata Supreme:**

1. Beshir Islami;
2. Rasim Rasimi dhe
3. Rafet Haxha;

VI. Të mos emërohen për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas kandidatët e

propozuar nga **Ministria për Kthim dhe Komunitete:**

1. Mita Staletoviq;
2. Marko Sibinoviç dhe
3. Drita Uglari;

VII. Të mos emërohen për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas kandidatët e propozuar

nga **Organizata Joqeveritare (OJQ):**

1. Nazife Jonuzi;
2. Halit Gashi dhe
3. Fitore Shala;

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2018, në bazë të dokumentacionit të ofruar nga propozuesit, për kandidatët e lartpërmendur për anëtar të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, në vështrim të nenit 11, të Ligjit, vlerësoi se kandidatët nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Oda e Avokatëve dhe Gjykata Supreme, nuk kanë pengesa ligjore, prandaj Komisioni i rekomandoi Kuvendit që njëri nga kandidatët e propozuar të emërohet anëtarë i Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

Komisioni në këtë mbledhje gjithashtu vlerësoi se kandidatët e propozuar nga Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe kandidatët e propozuar nga Organizata Joqeveritare, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 12 dhe nenin 14, të Ligjit nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, prandaj Komisioni i rekomandoi Kuvendit që të mos emërohen anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, asnjëri nga kandidatët e propozuar nga institucionet e lartcekura.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit u dakorduan, që me 8 vota për dhe 1 abstenim, të shtyhet për mbledhjen e radhës kjo pikë e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional, Projektligjin nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Korab Sejdiu, tha se në lidhje me këtë projektligj i ka drejtuar një pyetje Ministrin të Financave, pse ATK-ja nuk është duke e zbatuar këtë Ligj dhe është duke refuzuar ti njehë si shpenzime donacionet që subjektet private i japin për sportistë, artistë dhe për rini. Thjeshtë është një tentativë e ministrisë që e kalova edhe një ligj, por sërisht pjesëtarë të shoqërisë së kulturës, rinisë dhe sportit, po mbeten të pa sponsorim për arsye se ATK-ja nuk do të zbatojë ligjin nën pretendimin se ka kolizion të dy ligjeve dhe në shenjë revolte për moszbatim të këtij ligji nga ana e ATK-ja, Sejdiu tha se është kundër këtij projektligji.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 8 vota për dhe 1 votë kundër, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, për Projektligjin nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99 dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/99 dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i Sportit ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-115, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i Sportit, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

9. Të ndryshme.

A. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-122 për Forcën Ministrinë e Mbrojtjes;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

B. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën Sigurisë së Kosovës;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit, të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-123 për Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

C. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën Sigurisë ;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-124 për Shërbim në e Forcës së Sigurisë dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

D. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-085 për Referendum

Albulena Haxhiu, kryetare, tha se duhet të formojmë grupin e punës për Projektligjin nr. 06/L-085 për Referendum, i cili është miratuar në parim në seancë plenare.

Kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë, vendosi që të formohet grupi i punës si më poshtë.

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit në këtë përbërje:

1. Frashër Krasniqi, kryesues
2. Albulena Haxhiu, anëtare
3. Hajdar Beqa, anëtar
4. Sami Kurteshi, anëtar dhe
5. Bilall Sherifi, anëtar

Po ashtu, anëtarët e Komisionit u pajtuan, që të ftohen në mbledhjen e radhës së Komisionit Ministri i Drejtësisë, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor dhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, për të marrë informacione zyrtare dhe diskutuar në lidhje me gjendjen në Gjykatën e Kosovës në Veri të Mitrovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu